



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9430 Prot

Lezhë, më 26/05 /2022

VENDIM

Nr. 50, Datë 25.05 .2022

Për përdorim të fondit të emergjencës për “Rehabilitimi i murit mbajtës, në fshatin Spiten, Njësia Administrative Zejmen”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 1,196,268 lekë për mbulimin e shpenzimeve për “Rehabilitimin e murit mbajtës, në fshatin Spiten, Njësia Administrative Zejmen”.

Për këtë bëhen këto ndryshime në programet buxhetore si më poshtë;

- a. Pakësohet : Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.602 në shumën 1,196,268 lekë me këtë emërtim : “Ndërhyrje parandaluese”.
- b.Shtohet : Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.231 në shumën 1,196,268 lekë për objektin me emërtim: “Rehabilitimi i murit mbajtës, në fshatin Spiten, Nj.Administrative Zejmen”, me vlerë 1,196,268 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

